



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.77, datë 1.10.2018

PËR

**“RREGULLIMIN E TARIFAVE TË SIPËRMARRËSVE¹ ME FUQI TË NDJESHME NË
TREG PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE NË RRJETET E TYRE INDIVIDUALE
PUBLIKE TË TELEFONISË FIKSE DHE VENDOSJEN E MASAVE RREGULLUESE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës _____.____.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullore e Brendshme për Funkionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendim Nr.7, date 16.02.2017 shqyrtoi çështjen me objekt:

“Rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”

Dokumentacioni i DTMRr përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;

¹ Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë paraqitur në Listë në Aneksin 1 të këtij Vendimi.

- Dokumenti: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar”.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 55 e në vijim të Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
3. VKD Nr. 21 datë 30.03.2018, Për “Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar”;
4. VKD Nr.24, datë 30.03.2018, “Përcaktimin e sipërmarrësve² me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP (VKD) Nr.74, datë 1.10.2018, “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse – Dokument përfundimtar”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-vendimi për “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;
2. Dokumenti: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse - Dokumenti Përfundimtar”;
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (**Relacioni**).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.21 datë 30.03.2018 për “Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar” dhe me Vendimin Nr. 24, datë 30.03.2018, për “Përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të

² Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë paraqitur në Listë në Aneksin 1 të këtij Vendimi.

Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”, ka përcaktuar sipërmarrësit Alternativë sipas listës në Aneks 1 sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tyre fikse.

2. Këshilli Drejtues AKEP, pas procedurës 30 ditore të këshillimit publik, me Vendimin Nr.74, datë 1.10.2018, miratoi dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse*”– *Dokument përfundimtar*”. Ky dokument:
 - a) është përgatitur në përputhje me nenin 55 të Ligjit 9918 pas procedurës së këshillimit publik dhe ka marrë në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara;
 - b) ka marrë në konsideratë praktikën më të mira në vendet e BE dhe rajonit dhe kushtet e tregut Shqiptar;
 - c) është përgatitur në përputhje me përcaktimet në dokumentin *Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse – Dokument Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.21, datë 30.03.2018, dhe përcaktimet e VKD Nr. 24, datë 30.03.2018, për “*Përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese*”;
 - d) përmban arsyetimin për metodat e rregullimit të tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve të sipërmarrësve me FNT të rrjetin fikse.
3. Dokumenti *Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse* i miratuar me VKD Nr.74, datë 1.10.2018, shërben si pjesë arsyetuese për marrjen e këtij vendimi për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve alternativë të përcaktuar me FNT me VKD Nr.24, datë 30.03.2018.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

V E N D O S:

1. Në përputhje me pikën 1/a të nenit 57, të Ligjit 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, metoda e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve

alternativë të përcaktuar me FNT³, në tregun me shumicë të *terminimit të thirrjeve në rrjetin e tyre fiks*, është përcaktimi i nivelit maksimal sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme:

	Aktuale	01.12.2018	01.12.2019 – deri në një Vendim tjetër të AKEP
Tarifa e terminimit	<i>1.29</i>	<i>1.00</i>	<i>0.70</i>

Shënim: Tarifat në Lek/Minutë pa TVSH

2. Të njoftohen sipërmarrësit alternativë sipas listës bashkëngjitur të Aneks 1 për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. Alban **KARAPICI**
2. Edlira **DVORANI**
3. Ketrin **TOPÇIU**
4. Klarina **ALLUSHI**

³ VKD nr.24, datë 30.2.2018.

ANEKS 1.
LISTA E SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE TË
PËRCAKTUAR ME FNT PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE NË RRJETET E VETA
INDIVIDUALE

Nr.	SIPERMARRESI
1	4 ALB
2	ABCOM
3	ABISSNET Sh.a.
4	ACT
5	Albanian Tlc. Partners
6	ALBON
7	ALMA 2001
8	AMBE
9	Arsen Shahaj (P.F.)
10	ASC Sh.a.
11	UltraNet
12	BLETA Sh.p.k.
13	DOVA
14	Digicom
15	EDEN
16	EGIS-TEL 2004
17	ESDE Consulting
18	Ej & Bi
19	ELCOM
20	ENADA ONLINE
21	TELEKOM-KO sh.p.k (ish ESPACE)
22	Fjoers Online sh.p.k
23	FBD
24	Info Telecom
25	IVA ELEKTRONIK
26	MC Networking
27	Merita Xhika (P.F.)
28	Mobitel Communications
29	Neofone
30	NISATEL
31	Orikum Telecommunication
32	Pegasus Communications
33	Proton Communication
34	Professional Technologies

35	VIVO Communications
36	RU-TEL
37	SABATEL
38	SAJET
39	SELCOM
40	SHKODRA INTEL.TV
41	SINTEL
42	TEEB CENTER
43	Tele.Co&Constractions
44	TELEKOM POSTRIBA
45	Telekomunikacion Group
46	TELESYS-AB
47	TEL-KOM
48	Treg Tur Korca Sh.a.
49	UNIFI Holding INC
50	Vodafone Albania Sh.a.(F)
51	VOSKOPI
52	Vraniger Communications
53	VASFI BALLA(P.F.)
54	XHENI AD
55	ZERO GRAVITET
56	Professional Technologies
57	GrupKom
58	ESDE Consulting
59	ELITE TELECOMMUNICATION
60	RAYSTORM sh.p.k
61	ENET sh.p.k
62	Frengli Sherifi
63	FUTURE TELECOM sh.p.k.
64	Edi-2004 sh.p.k.
65	Alser sh.p.k.
66	METIS COMMUNICATIONS sh.p.k.
67	FOXCOM sh.p.k.